



Prishtinë: 10.12.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1335_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2104_10_20**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **16.11.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 10.12.2020 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin Sh.G. nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2104_10_20 i datës 19.10.2020.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 06.10.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-s, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë, ndaj konsumatorit Sh.G. nga Komuna e Prishtinës lidhur me kundërshtimin ndaj faturës së muajit maj 2018. Në ankesë theksohet se faturimi për periudhat 05/2018 deri më 12/2018 sipas KESCO është i saktë dhe i bazuar në të dhënat e shpenzimit të njehsorit elektrik. Në ankesë KESCO ka theksuar se krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike të bërë nga DMK në ZRRE të periudhës 05/2018 deri më 12/2018 me periudhat 2015, 2017 dhe 2019 nuk është krejt i saktë pasi është dashur të analizohen edhe periudha tjera si ajo 01/2019. KESCO në ankesë kanë theksuar se punëtorët e autorizuar të KESCO me datë 06.11.2020 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se konsumatori është duke bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike ku përmes fazës L3 është bërë anashkalim i matjes, dhe se kjo paraqet provë të rëndësishme në shqyrtimin e ankesës së konsumatorit për anulim të faturave të muajit 05/2018 deri 12/2018. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2104_10_20, i datës 19.10.2020, për konsumatorin Sh.G.me shifër DPR - 33365.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.12.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO se faturimi për periudhat 05/2018 deri më 12/2018 sipas KESCO është i saktë, Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në të gjitha analizat e bëra shkresave të lëndës shpenzimet e energjisë elektrike nga periudha 05/2018 deri në periudhën 12/2018 nuk paraqesin



shpenzime reale të konsumatorit, e kjo shihet edhe nga analiza e bërë shpenzimit të energjisë elektrike, respektivisht krahasimit të shpenzimit të energjisë elektrike të periudhave 05/2018 – 12/2018 me periudhat e njëjta të viteve 2015, 2017, 2019 dhe 2020. Bordi i ZRRE thekson se bazuar në këto analiza të shpenzimit të energjisë elektrike shihet qartë se konsumatori ka dallim në shpenzim të periudhës kontestuese në krahasim me periudhat tjera jo kontestuese.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO se krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike të bërë nga DMK në ZRRE të periudhës 05/2018 deri më 12/2018 me periudhat 2015, 2017 dhe 2019 nuk është krejt i saktë, Bordi i ZRRE thekson se edhe kjo nuk qëndron pasi që krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike është indikator mjaft i rëndësishëm në procesin e shqyrtimit të lëndëve të konsumatorëve. Bordi i ZRRE thekson se me të drejtë organi i shkallës së parë i ZRRE (DMK në ZRRE) ka bërë krahasimin e shpenzimeve të energjisë elektrike të periudhës 05/2018 deri më 12/2018 me periudhat e njëjta të viteve si paraprake ashtu edhe pas saj, e kjo me qëllim të krahasimit sa më të saktë të shpenzimit të energjisë elektrike. Bordi i ZRRE thekson se bazuar në shpenzimet e energjisë elektrike të paraqitura në rrjedhën e energjisë elektrike ka vërejtur se: me njehsorin elektrike nr.34886375 për periudhën 05/2015 deri në periudhën 12/2015 është 267 kWh/muaj, me njehsorin elektrike nr.64682731 mesatarja e shpenzimeve për periudhën 05/2017 deri në periudhën 12/2017 është 287 kWh/muaj, me njehsorin elektrik nr.40554549 për periudhën 05/2018 deri në periudhën 12/2018 është 890 kWh/muaj, me njehsorin elektrik nr.44169722 për periudhën 05/2019 deri në periudhën 12/2019 është 228 kWh/muaj, si dhe për periudhën 05/2020 deri në periudhën 09/2020 është 250 kWh/muaj. Pra Bordi i ZRRE thekson se nga këto analiza shihet qartë se shpenzimi i energjisë elektrike i periudhës 05/2018 deri më 12/2018 me njehsorin elektrik nr.40554549 ka dallim në krahasim me shpenzimet e energjisë elektrike të periudhave tjera. Ndërsa sa i përket periudhës së cekur nga KESCO që në periudhën 01/2019 shpenzim i konsumatorit ka qenë 1,106 kWh dhe 05/2020 prej 1,032 kWh, se duhet të analizohet edhe me këto periudha, Bordi i ZRRE ka theksuar se krahasimi i shpenzimit duhet të bëhet në periudha të njëjta kohore dhe jo në periudha tjera, pasi që krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike duhet të bëhet për periudha të njëjta dhe jo për periudha tjera pasi krahasimi nuk mund të jetë i saktë.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO se punëtorët e autorizuar të KESCO me datë 06.11.2020 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se konsumatori është duke bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, dhe se kjo paraqet provë të rëndësishme në shqyrtimin e ankesës së konsumatorit për anulim të faturave të muajit 05/2018 deri 12/2018, Bordi i ZRRE thekson se kjo provë nuk duhet të merret si provë, pasi që nuk është pjesë e procesit të shqyrtimit të lëndës së konsumatorit, dhe se konsumatori ka kontestuar faturimin e periudhës 05/2018 – 12/2018, ndërsa punëtorët e autorizuar të KESCO me datë 06.11.2020 kanë bërë një konstatim të tillë, i cili nuk është relevant me rastin. Gjithashtu duhet theksuar se edhe vet KESCO në përgjigjen e tyre ndaj konsumatorit dhenë me datë 23.06.2018 nuk e kanë evidentuar këtë çështje, pasi që nuk është objekt i shqyrtimit të lëndës së konsumatorit, andaj edhe nuk duhet të merret për bazë në këtë proces. Bordi i ZRRE thekson se për të gjitha rastet kur punëtorët e autorizuar të KEDS-it hasin në shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, atëherë janë të detyruar të veprojnë konform nenit 61 të Ligjit për Energjinë Elektrike, dispozitave ligjore të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, dhe se edhe në rastin konkret KEDS është i obliguar të respektoj të gjitha dispozitat ligjore të ligjeve dhe rregullave të lartcekura lidhur me konstatimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE ju thekson se bazuar në dispozitat e nenit 4 paragrafi 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, theksohet: *“Çdo ankesë ose kontest që lidhet me elementet e veprës penale dhe vjedhjes së energjisë elektrike, të përcaktuara në nenin 61 të Ligjit për*



Energji Elektrike, si dhe me dispozitat ligjore siç përcaktohen në Kapitullin XXVI të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Veprat Penale Kundër Shërbimeve Komunale, ku përfshihet edhe vjedhja e energjisë termike (ngrohja qendrore) janë nën juridiksionin e gjykatës kompetente, andaj këto ankesa ose konteste nuk trajtohen në këtë rregull”, ZRRE nuk ka kompetencë që të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, dhe kompetente për zgjidhjen e kësaj ankesë është vetëm gjykata.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij ka ofruar procesverbalin nr.0726716 të datës 06.11.2020 për të vërtetuar argumentet e KEDS/KESCO, por që Bordi i ZRRE ka konstatuar se prova e ofruar nuk është provë e cila duhet të merret parasysh pasi nuk ka të bëjë me ankesën e konsumatorit për faturat e periudhë 05/2018 – 12/2018 dhe nuk ndërlidhet me rastin në fjalë, andaj konstaton se vendimi i DMK-së në ZRRE si organ i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 10.12.2020 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit Sh.G.dhe
- Arkivit të ZRRE-së.